



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

02-12-2011

Titulli i Pronës	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
	02-013	/	2146



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 40 paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 35 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 23.11.2011 aprovon këtë:

V E N D I M

PËR BARTJEN E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË PALUJTËSHMËRISË (TOKËS) NË PRONËSI SHOQËRORE - PRONË E KUVENDIT KOMUNAL TË VITISË NË SHFRYTËZUESIN E RI KËSHILLI I BASHKËSISË ISLAME NË VITI – XHAMIA NË FSHATIN BINÇË

Neni 1

Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë, LEJON bartjen administrative të së drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme (tokës) e cila evidentohet në ngastrën kadastrave 1607-3 dhe 1648-2 në vendi i quajtur Malishte, në sipërfaqe prej 1000m², Zona kadastrave Binçë, nga pronari i mëparshëm pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal në Viti, në shfrytëzuesin e ri Këshilli i Bashkësisë Islame në Viti, për ndërtimin e xhamisë në fshatin Binçë - lagjia Shushtë.

Neni 2

Bartja administrative e të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme nga neni 1 i këtij vendimi, bëhet pa kompensim duke u bazuar në kërkesën me nr 07-07/1685 e datës 22.05.2011 të Këshillit të Bashkësisë Islame drejtuar Drejtorisë për Kadastër-Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Vitisë.

Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Drejtorja për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë, obligohet që të bëjë ndërrimin në regjistrin kadastral, në emër të shfrytëzuesit të ri – Këshilli i Bashkësisë Islame në Viti – Xhamia në fshatin Binçë- lagja e Shushtë.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtorja për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

O1.Nr. _____
Viti, 01.12.2011



KRYESUESI I KUVENDIT
Skenderbe Hebibaj